



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 46, datë 28.04.2017**

**PËR**

**MIRATIMIN E AGJENTËVE NË SIGURIME, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË  
SHOQËRISË SË SIGURIMIT “SIGMA INTERALBANIAN VIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 199, pika 2, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, me propozim të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e Jo-Jetës, të Z. Gramoz Sitaj, Zj. Mimoza Xakollari, Z. Ledio Llupi, Z. Pavllo Gjini dhe Z. Albert Kuka, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit “Sigma Interalbanian VIG” sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**